

---

# Konsultimi me publikun

---

**“Terminal per depozitimin e karburant JET-A1”**

---

Shtator 2018

---

## 1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

### 1.1 Qellimi i projektit

Shoqëria “AV Gaz” sh.a ka ne pronesi depozita te magazinimit te karburant JET-A1 me vendndodhje Porto Romano, Durres.

### 1.2 Objektivat e aktivitetit

Objektivi I pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Shkarkimet ne ujera nga procesi teknologjik
- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi I dyte I ketij aktiviteti eshte do te jete gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

### 1.3 Vendodhja dhe karakteristikat fizike te projektit

Vendodhja e impiantit eshte ne Porto Romano, Durres




Fig.1 Vendodhja e objektit

Koordinatat e subjektit AV Gas paraqiten ne tabelen e meposhteme.

Pikat	X	Y
1.	4368416.086	4584340.424
2.	4368572.669	4584416.549
3.	4368547.368	4584092.300
4.	4368705.351	4584191.303

## 1.4 Procesi teknologjik

Ambientet per platformen e re te depozitave ne Aeroportin e Tiranes do te instalohet ne nje hapësire te gardhuar te gjelber vendosur brenda aeroportit dhe ngjitur me platformen egzistuese te depozitave Jet A1: koordinatat e zones tregohen me larte. Dimensionet e depozites se re do te jene 70m x 50m. dhe aksesit do te sigurohet nepermjet nje rruge te re qe lidhet me rruget e jashtme egzistuese te Kompanise AV Gas.

### 1.4.1 Impianti do te perbehet nga:

- Sistemi I Shkarkim/Ngarkimit
- Sistemi I depozitave
- Sistemi I mbrojtjes nga zjarri
- Sistemi I kullimit
- Sistemi I kontrollit
- Sistemi elektrik
- Ndertesa te zyrave dhe ambienteve teknike

Impianti do te ndahet me nje gardh te ri (rrjete teli metalike) perreth gjithë vendit te larte 2.5m (minimalisht), do te sigurohen dy hyrje kryesore per automjete (nje per hyrje dhe nje per dalje) dhe nje porte kryesore per kalimtare do te lejoje akses ne ndertesën e zyrave dhe ambienteve teknike. Pergjate gardhit do te realizohen porta shtese per kalimtare vetem per raste emergjencash.

Hapësira brenda impiantit te ri dhe zonat e automjeteve do te asfaltohen dhe do te krijohet nje pjerresi ne drejtim te bazeneve qe mbledhin ujin e shiut; uji I mbledhur do te nxirret jashte drejt rrjetit egzistues per ujin e shiut te aeroportit. Zona e perpunimit (stacionet e pompave, paketat e filtrave, skelat e shkarkimi/ngarkimit) do te pajisen me siperfaqe te shtruar me pimento me bankina kufizuese (kanalet e kullimit per skelat e shkarkimit/ngarkimit) dhe uji I ndotur me nafte do te mblidhet ne nje ene kullimi nga sistemi I kullimit. Zonat qe ngelen do te mbushen me zhavorr (ngritje 10 cm mbi zonen e asfaltar). Sistemi I tubacionit do te projektohet sipas kodeve te aplikueshme ASME dhe standarteve autoritetit lokal. Tubacionet do te behen me gelik karboni dhe do te instalohen mbi toke dhe nen toke, tubacioni mbi toke do te lyhet me boje ne pjesen e jashtme ndersa tubacioni nen toke do te vishet me nje shtrese; vetem tubacioni nentoke I sistemit kunder zjarrit do te behet me PEDL.

Sistemet e tubacioneve do te pajisen me valvula per glirim termik per te mbrojtur linjat dhe pajisjet nga zgjerimi termik (bymimi), shkarkimi I valvulave te glirimit termik do te mbeshtetet sig duhet nga struktura geliku ose suporte betoni. Jashte gardhit te impiantit, mund te realizohet nje parkim per makinat e vizitoreve.

### 1.4.2 Sistemi I depozitave

Jet A1 do të depozitohet në nr. 3 ene (tag nr. 100-V-001/002/003), me kapacitet neto të çdo ene 80 m.

Enet janë të tipit shell (ene e madhe presioni) horizontal/dopio, instaluar nën tokë dhe të pajisura me:

- Valvula manuale si në linjen hyrëse edhe në atë dalje.
- Pajisje për të lejuar rrjedhjen e lirë (*free vent devices*).
- Instrumentim niveli që do të japë indikacion për nivelin dhe alarm për nivel të ulët/te lartë; gjithashtu, pompa e shkarkimit do të ndalohet në rast niveli shumë të lartë.
- Puseta dhe kapake.
- Linja të kthimit të avujve nga skela e ngarkimit.
- Enet do të pajisen me tub thithje pluskues të brendshëm me qellim që të shmangët thithja e karburantit Jet nga fundi i enes.
- Ena do të projektohet për të shmangur ndotjen e dheut në rast defekti.

Tubi i vendosur mbi tokë që i kushtohet sistemit të depozitimit, do të pajiset me një shtrim pimento me bankina kufizuese atje ku mund të ketë rrjedhje të mundshme, dhe pajisja që mundeson rrjedhjen e lirë do të vendoset në një zonë të sigurtë. Do të sigurohet një pompe për kullim, e tipit vete-startues, për zbrazje të plote të enëve të depozitimit kur kërkohet për mirembajtjen e tyre. Linja e shkarkimit do të drejtohet larg drejt enës së kullimit të sistemit të kullimit.

### 1.4.3 Sistemi i Mbrojtjes Kunder Zjarrit

Platforma e depozitave në Aeroportin e Tiranës do të mbrohet nga një sistem aktiv i Mbrojtjes Kunder Zjarrit, që do të konceptohet si një rrjet kunder zjarrit me ujë i nëndheshëm (tub PEDL), i mirembajtur i lagur në kushte normale; kompleksi kryesor do të pajiset me hidrante, vendosur në pozicione strategjike.

Për qellime të shuarjes së zjarrit, do të sigurohet një njësi shkume mobile/e levizshme, me qellim që të perdoret në rast zjarri ose në zonën ku janë strehuar pompat/filtrat e Jet A1 ose tek zona e ngarkimit/shkarkimit. Kërkesa minimale për ujë kunder zjarrit varet nga skenari me I keq, që identifikohet në rastin e zjarrit në zonën e pompave të Jet A1.

I gjithë sistemi do të jetë i aktivizuar me dorë/manualisht.

Prandaj, sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit përbehet kryesisht nga ambientet e mëposhtme:

- Kompleksi kryesor i ujit për shuarje zjarri ND 6". pajisur me 6 hidrante. kuti për tubat plastike dhe valvula izolimi (për të seksionalizuar kompleksin gjatë mirembajtjes):
- Nr. 2 pompa kryesore me ujë kunder zjarrit: një pompe elektrike (tag nr. 100-P-004) dhe një me pompe naftë "diesel" (tag nr. 100-P-005): kapaciteti i pompës është 170 m<sup>3</sup>/h. Pompa me naftë do të pajiset me një ene naftë/diesel ditore, që mbushet me dorë kur është e nevojshme;
- Nr. 1 pompe elektrike me presion për ujë kunder zjarrit (100-P-003): kapaciteti i pompës është 23 m<sup>3</sup>/h;
- Nr. 1 ene horizontale për ujë kunder zjarrit (instaluar mbi tokë): kapaciteti i enës është 65 m<sup>3</sup>. Është në gjendje për të përmbushur në mënyrë të kënaqshme edhe skenarin me të keq të zjarrit të identifikuar;
- Nr. 1 pakete ene presioni tip termus (tag nr. 100-PK-001). për të ngritur në start të menjëhershëm me presion në një rast të një rrjedhje të vogël të ujit kunder zjarrit;

- Nr. 1 niesi te levizshme shkume (si rimorkio e nalisur me koncentrat te perqendruar shkume AFFF. Nr. 1 tub erte lidhur hidrantin dhe monitorin Nr. 1); Sasia minimale e depozites se kerkuarte shkumes eshte 180 I.

Pervec sistemit fiks te mbrojtjes kunder zjarrit, tek zona e platformes se re te depozitave do te sigurohen nje sasi e mjaftueshme e fikesve te zjarrit mbi rrota ose portativ si dhe nje Sistem I Alarmit kunder Zjarrit, qe perfshin detektore dhe sinjale te degjueshme/te dukshme per te treguar vendndodhjen e incidentit te zjarrit dhe per te komunikuar emergjencen tek njesia kunder zjarrit e aeroportit.

#### **1.4.4 Sistem I mbyllur kullimi**

Sistemi I kullimit do te mbledhe te gjitha rrjedhjet e naftes nga pajisjet (te tilla si filtra, pompa dhe ene depozitash), valvulat termike te shkarkimit dhe gropat e gimentos per te bere grumbullimin e ujit nga zonat e shtrimit me gimento.

Sistemi do te perbehet nga:

- Rriet tubash nentoke (gelik karboni I veshur):
- Nr. 1 ene kullimi. tip horizontal, instaluar nen toke me nje kapacitet prej 10 m<sup>3</sup> (per t'u konfirmuar).

#### **1.4.5 Sistem kontrolli**

Sistemi I depozitimit te karburantit do te menaxhohet lokalisht dhe manualisht, megjithate do te instalohet nje sistem kontrolli automatik perte perqendruar alarmet dhe sistemet e sigurise me marrje masash te automatizuara.

Sistemi I kontrollit do te bazohet ne PLC standarte industriale dhe do te marre statusin e pompes nivelet e depozites.

Gjithe informacioni do te shfaqet mbi nje ekran me touch/prekje te ngritur mbi panel. PLC do te jete ne interface dhe do te integrohet me Sistemin e Alarmit per Zjarrin EN-54 qe do te menaxhoje detektoret e zjarrit dhe butonat qe shtypen per emergjencat. Te gjitha alarmet dhe sistemet e sigurise te automatizuara do te jene te perqendruara.

Sistemi I Alarmit per Zjarrin do te jete ne gjendje te beje thirrje te automatizuara per alarm kunder zjarrit tek njesia kunder zjarrit e aeroportit. Pervec sistemit te kontrollit inventari I produkteve do te menaxhohet nga nje sistem I dedikuar, qe, duke filluar prej matjeve te matesve PD, do te jape te gjithe informacionin dhe te dhenat kontabel per menaxhimin e depozitave.

Gjithashtu do te sigurohet edhe nje sistem CCTV per regjistrim te vazhduar te operimit dhe per mbikqyrje te sigurise.

Depozitat do te pajisen me matje te vazhdueshme niveli dhe zbulim te pavarur te nivelit te larte/ulet. Sistemi I matjes se nivelit do te aprovohet jo per menaxhim inventari.

Instrumentimi I terrenit do te jete preferencialisht me ekzekutim ATEX Ex-i ose, kur nuk eshte i aplikueshem ekzekutimi EX-d/e sipas EN 60079.

## 2 . IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

### 2.1 Metodologjia

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarisë, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta.

Vlerësimi I ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të nje territori të caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve të mjedisit klasifikohet në:
  - Mbrojtja e ajrit
  - Mbrojtja e ujërave
  - Mbrojtja e tokës
  - Mbrojtja e natyrës
  - Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne peizazhin e zones
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma)
- Zhurmat dhe vibrimet
- Shkarkimet e lengeta
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi I tyre
- Ndikime socio-ekonomike
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Shpjegim
<b>Pejsazhi</b>	Ndryshim i pejsazhit te zones	Do te kete nje ndryshim te pejsazhit te zones, nga nje zone me karakter bujqesor ne nje aktiviteti industrial, me levizje autobotesh dhe mjetesh te tjera ne menyre te vazhdueshme. Por duhet theksuar se zona ka nje te ardhme per zhvillim industrial, keshtu nuk mund ta konsiderojme si ndikim rrenjesor.
<b>Toke</b>	Ngjeshje e tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne strukturen e tokes perreth zones se aktivitetit.
	Erozion i tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne erozionin e tokes perreth zones se aktivitetit. Siperfaqja e zones eshte pothuajse e rrafshet dhe e stabilizuar.
	Ndotje e tokes	Shoqeria gjate aktivitetit te saj nuk do te kete shkarkime te lengeta apo te ngurta ne toke. Emisione te mundshme vajra dhe karburante qe mund te emetohen ne menyre aksidentale nga mjetet e transportit, gjate furnizimit te gjeneratorit dhe mjeteve me karburant.
<b>Uje</b>	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Ndotja e ujerave siperfaqesore mund te shkaktohet vetem ne raste rrjedhesh nga mjetet e transportit dhe nepermjet shiut te pare rrjedh drejt ujerave siperfaqesore
	Ndotje e ujerave nentokesore	Edhe per ujerat nentokesor vlen i njejti vleresim si per ujerat siperfaqesor.

<b>Ajer</b>	Emisione gazesh	Emisione te gazit natyror mund te kete ne nivele minimale vetem gjate procesit te mbushjes se bombulave per perdorim shtepiak. Kjo ndodh ne pjesen perfundimtare vetem kur shkeputet lidhja midis tubacionit dhe bombules. Kjo do te jete ne nivele te paperfillshme.
	Zhurme,vibrime	Nuk do te kete shkaktim zhurme nga aktiviteti i impiantit. Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate furinizmit te cisternave. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. Gjithashtu zhurme mund te shkaktohet edhe nga gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise. Theksohet se nuk ka zona te banuara ne afersi te zones se impiantit.
<b>Mjedisi biologjik</b>	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i impiantit te depozitimit te naftes dhe as nga tregtimi i tij.
<b>Mjedisi human</b>	Shqetesim te banoreve	Gjenden pak banesa ne afersi te zones se projektit. Gjithashtu e ardhmja e zones do te jete per zhvillim te aktiviteteve ekonomike industriale.
<b>Ndikimet te tjera te projektit</b>	Ndikimet ne trafik	Zona ka fluks te madh trafiku duke qene se ndodhet ne aksin kryesor te Shqiperise. Aktiviteti mund te ndikojte ne shtimin e trafikut te zones por megjithate ne nivele te pakonsuderueshme.
	Konsumi i energjise	Energjia e perdorur eshte energjia elektrike, dhe vleresohet se nuk ka konsum te larte te energjise. Gjeneratori do te perdoret vetem ne raste nderprerje energjie.
	Rreziku i zjarrit dhe incidenteve	Nafta eshte mjaft i djegshem dhe nese eshte ne gjendje te lire ne atmoferet mund te digjet lehtesisht vetem nepermjet nje shkendie. Shoqeria ka marre te gjitha masat e sigurise jo vetem te teknologjise qe te mos kete rrjedhje, por edhe te pajisjeve te tjera qe mund te shkaktojne shkendia. Stafi eshte i trajnuar per sigurine ne pune dhe rrezikun nga zjarri.



## 3. MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

### 3.1 - Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate fazes se ndertimit dhe ushtrimit te tij duhet te merren masat e duhura nga shoqeria "AV Gas" Sh.a

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit qe do te merren ndahen ne:

1. teknike
2. organizative

#### Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
<b>Parandalim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Perzgjedhja e teknologjise me cikël te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore</li> <li>- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar</li> <li>- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit</li> <li>- Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje e filtrave te kapjes se pluhurit dhe gazeve</li> <li>- Perdorimi i naftes D1 per kamionet</li> <li>- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj</li> <li>- Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj</li> <li>- Sigurimi i vendit ku depozitohen mbetjet e ngurta duke krijuar bordura te ngritura qe edhe nese rrjdhin papasterti prej tyre te qendrojne brenda siperfaqes se percaktuar, per te mos lejuar ndotje prej tyre ne mjedisin perreth.</li> </ul>
<b>Kontroll</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash</li> <li>- Kompaktesim dhe lagie e inerteve ne qiell te hapur</li> <li>- Gjeneratori duhet te rrethohet me mur dhe te kete nje vend te vecante</li> </ul>
<b>Nderhyrje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike</li> <li>- Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh.</li> <li>- Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale</li> <li>- Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)</li> </ul>
<b>Administrim</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.</li> </ul>

### 3.2 Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit (aerosole)	cilësisa e ajrit dhe pluhurit ka si qellim te vleresoje cilesine e tij te ndikuar nga aktiviteti prodhues, ne kete rast per te kontrolluar filtrat qe kapin grimcat. Siloset jane te pajisur me filtra me mende ne pjesen e siperme te tyre.
2	Emetim gazesh nga automjetet qe do kryejne punimet	Sasia do te jete minimale por duhet te punohet me eficence dhe te ulet koha e mbajtjes ndezur pa qene nevoja e motoreve te mjeteve.
3	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;

### 3.3 Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit e kantierit do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne Mbetjet inerte do te menaxhohen ne bashkepunim me perfaqesues te Njesise se Qeverisjes Vendore. Keto mbetje do te depozitohen ne nje zone te caktuar nga Bashkia ose do te kryhet menaxhimi i integruar i mbetjeve te ngurta duke i seleksionuar dhe menaxhuar nepermjet kontratave kontaktuale me Njesine e Qeverisjes Vendore ose subjekte te licensuar per kete qellim. Asnje mbetje e ngurte nuk do te hidhet ne mjediset ujore dhe ate tokesore te zones.

### 3.4 Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (ARM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne ARM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

<b>Nr</b>	<b>Natyra e monitorimit</b>	<b>Frekuenca</b>	<b>Analiza</b>
2	Monitorimi i shkarkimeve te gazta nga aktiviteti	Periodike (Cdo 3 muaj)	LNP, Nox, Cox, SOx
3	Matja - Listimi i te gjitha mbeturinave dhe krahsimi me standartet ISO 1990/2000.	Çdo jave	Peshimi dhe asgjesim/riciklimi i tyre
4	Monitorimi i zhurmes se shkaktuar	Periodik (raportim cdo 3 muaj)	Zhurma db(A) nga aktiviteti i prodhimit te impianteve ne 2 pika ne rrethim te kapanonit

\* Cdo parameter dhe ndikim qe mund te identifikohet nga aktiviteti mund te shtohet si parameter per tu monitoruar